

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna Hani i Elezit**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **659-25-1656-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material per stomatologji**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Pro Medical."

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kadri Zeka Nr.22

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049-631-245

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Adnan Bala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

promedical.fr@gmail.com

(Adresa elektronike)



01.05.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 13.03.2025
Data e hapjes së ofertave: 18.03.2025
Letrat standarde :18.04.2025
Refuzimi i kërkeses për rishqyrtim me date:24.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

24.04.2025 AK mer Vendim për KËRKESË PËR RISHQYRTIM

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen

e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ankesa jonë paraqiten dy pretendime kryesore ndaj Autoritetit Kontraktues (AK):

Pretendimi 1: Shkelje e nenit 59 të LPP, lidhur me korrigjimin e pasaktë të çmimeve me TVSh të ofertave të Operatorëve Ekonomikë. AK ka ndryshuar në mënyrë të gabuar çmimin total me TVSh të OE-së të rekomanduar, nga **866.40 €** në **792.98 €**, duke e kalkuluar gabimisht çmimin me TVSh.

Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues ka lejuar një devijim prej **8.47%** në çmimin e ofertës së operatorit “Alfa Dent” ($866.40 € - 792.98 € = 73.42 €$), duke tejkaluar kufirin maksimal të lejuar prej **2%** sepse korrigjimi është bërë tek çmimi me TVSh. Ky tejkalim duhej të rezultonte në **eliminimin e operatorit** nga procedura prokurimit.

2. Bazat Ligjore të Shkeljeve

a. Shkelje e Nenit 59 të LPP-së- *Neni 59.4: AK nuk mund të modifikojë / ndryshoj çmimin me TVSh të ofertës, pasi ky është i detyrueshëm për operatorët ekonomikë. Korrigjimi i lejuar është vetëm i normës së TVSh-së për të arritur çmimin pa TVSH, pa ndikuar në totalin e Çmimit me TVSh.*

b. Shkelje e Parimeve Themelore Neni 7 LPP -Barazia dhe Jo-diskriminimi: *AK favorizoi "Alfa Dent" duke pranuar devijime të padrejta dhe duke ndryshuar total e Çmimit me TVSh.*

c. Shkelje e Nenit 27 Dosja e Tenderit- *si Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën pra 5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.*

AK kërkoi që ofertat të paraqiteshin me të gjitha taksat (përfshirë TVSh-në), por pastaj ndryshoi kushtet e ofertës, duke krijuar mospërputhje me kërkesat fillestare.

d. Shkelje e Nenit 59.3 dhe të Rregullores për Prokurim Publik 40.9(b)- *Gabimet aritmetike mbi 2% duhet të çojnë në eliminim të ofertës. AK pranoi një gabim prej 8.47%, për OE Alfa Dent duke shkelur këtë dispozitë.*

3. Kërkesat e OE “Pro Medical”

Anulimi i vendimit të AK-së (B58, dt. 18.04.2025).

Rivlerësim i aktivitetit të prokurimit në përputhje me LPP-në.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si palë e interesuar – në përputhje me kuptimin e pikës 1.26 të nenit 4 ne paraqesim këtë Kërkesë për Rishqyrtim dhe duke u bazuar ne LPP dhe Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024 Neni 60.

Ne kemi pasur qasje në dokumentet e operatorit ekonomik të rekomanduar, mirëpo AK, në mënyrë të tendencioze, na ka detyruar të paguajmë 28 euro për 14 faqe, duke aplikuar një tarifë prej 2 euro për faqe. Kjo bie në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit për Mjetet për Promovimin e Transparencës, paragrafi 7, i cili përcakton se KRPP do të vendosë në rregullat e prokurimit publik një tarifë të arsyeshme që autoritetet kontraktuese dhe KRPP-ja mund ta aplikojnë për të mbuluar vetëm shpenzimet reale të fotokopjimit, siç parashihet në paragrafin 5 të këtij neni. Sidoqoftë, tarifa e tillë nuk duhet të tejkalojë shpenzimet reale që lidhen me prodhimin e kopjeve të tilla.

Tarifa prej 2 euro për faqe është një anomali, veçanërisht në rastin e dosjes së tenderit, e cila është voluminoze. Një palë e interesuar mund të detyrohet të paguajë mbi 100 euro vetëm për të pasur qasje në dokumentacionin përkatës, gjë që është e pajustifikueshme dhe cënon parimet e transparencës në prokurimin publik. Kjo është edhe më shqetësuese duke marrë parasysh faktin se Autoriteti Kontraktues në fjalë ka refuzuar të ofrojë qasje elektronike përmes e-mailit, pavarësisht se kjo do të ishte mënyra më efikase, transparente dhe pa kosto për palët e interesuara.

Ne shprehim dyshime serioze se Zyra e Prokurimit nuk e ka kryer vlerësimin në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht me nenin 59, duke bërë ndërhyrje apo korrigjime në paramasë kundërshtim me këtë ligj. Si rrjedhojë, rezultatet përfundimtare janë ndryshuar në krahasim me ato të pasqyruara në procesverbalin e hapjes së ofertave, ofertat financiare të dorëzuara nga operatorët ekonomikë dhe formularët e tenderit, përfshirë përshkrimin total të çmimit.

Autoriteti kontraktues, duke vepruar në këtë mënyrë, ka shkelur parimet themelore të prokurimit publik, konkretisht nenin 7, paragrafin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke mos vepruar në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe jo-diskriminuese.

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve sipas Nenit 59 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues (AK), përkatësisht personat përgjegjës për vlerësimin e ofertave, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Në procesverbalin e hapjes së ofertave, është evidentuar se Operatorit Ekonomik "Alfa Dent" i është konstatuar një mospërputhje në normën e TVSh-së—ka aplikuar normën 18% në vend të normës së reduktuar prej 8%, siç pasqyrohet në procesverbalin e hapjes së ofertave (shih provën më poshtë), si dhe në Formularin e tenderit të ofertës B56.

Megjithatë, AK, në vend që të korrigjonte vetëm normën e TVSh-së duke llogaritur saktë çmimin pa TVSh, ka ndryshuar në mënyrë të paarsyeshme shumën totale të ofertës pra Çmimin me TVSh nga 866.40 € në 792.98 € të OE Alfa Dent.

AK ka qenë i obliguar të veprojë ndryshe, duke marrë parasysh se çmimi total me TVSh i ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar ishte 866.40 €. Korrigjimi i saktë, në përputhje me normën e TVSh-së prej 8%, do të ishte:

$866.40 \text{ €} / 1.08 = 802.22 \text{ €}$ (Çmimi total pa TVSh për OE Alfa Dent).

Ky rast duhet të trajtohet në përputhje me opinionin e dhënë nga KRPP lidhur me korrigjimin e TVSh-së. Për këtë arsye, nuk kërkohet njoftimi i operatorit ekonomik, pasi nuk kemi të bëjmë me ndryshim të çmimit total me TVSH, por vetëm me korrigjimin e çmimit pa TVSh. Megjithatë, në këtë rast, AK ka ndryshuar padrejtësisht edhe çmimin total me TVSh.

Ndërkohë, AK ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), dhe ky veprim ka rezultuar në:

- ***Shkelje të nenit 59 të LPP-së, i cili ndalon ndryshimet arbitrare të çmimeve me TVSh.***
- ***Cënim të parimit të transparencës dhe barazisë, duke favorizuar një operator ekonomik në dëm të konkurrentëve të tjerë.***
- ***Krijimin e një precedenti të rrezikshëm, që mund të hapë rrugë për manipulime të ofertave në prokurimet e ardhshme.***

Këto veprime të AK-së përbëjnë bazën e dy pretendimeve tona kryesore në Ankesën tonë ndaj AK.

Pretendimi 1

Meqenëse në rastin konkret në procesverbal figurojnë dy çmime të ndara – me dhe pa TVSh pra Çmimi (pa TVSh) dhe Çmimi (me TVSh) reference procesverbali shiko ju lutem kurse – Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh se çmimi me TVSh është ai që mbizotëron dhe nuk mund të ndryshohet nga asnjëra palë, përveç në rastet kur ka gabime aritmetike ($\pm 2\%$), sipas nenit 59.3 të LPP.

Çdo ndryshim i tillë përtej këtij rasti do të përbënte një ndërhyrje materiale, e cila bie ndesh me nenin 59.4 të LPP-së dhe me **Rregulloren për Prokurimin Publik, neni 40.9 (pika a dhe b).**

Diferencat ndërmjet çmimit me TVSh dhe atij pa TVSh përbëjnë një element tatimor, i cili paguhet nga OE në drejtim të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Për më tepër, në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se Operatori Ekonomik duhet të paraqesë ofertën me të gjitha çmimet dhe taksat e aplikueshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Ritheksojmë se korrigjimi, në raste të tilla, duhet të bëhet në këtë formë:

Çmimi me TVSh / norma e TVSh-së (1.08 për 8%) = Çmimi pa TVSh.

Pra, çdo korrigjim duhet të aplikohet vetëm mbi çmimin pa TVSH – dhe jo anasjelltas, siç ka vepruar në mënyrë të gabuar Autoriteti Kontraktues.

Procesverbale i hapjes

Datum izdavanja	Datum zatvaranja & Čas	Datum Otvaranja & Čas	Mesto	Br. Primljenih Tendera
18.03.2025	18.03.2025, 14:00:00	18.03.2025, 14:00:00	Permes platformes se prokurimit elektronik	3

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	VitaMed L.L.C., Rr. Ramadan Peci, 40000, Mitrovice	17.03.2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja te QKMF-së	PO	1285.57	1517.00	JO
2.	PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj	02/2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja te QKMF-së	PO	778.00	846.50	JO
3.	Alfa Dent SH.P.K., Rr.Ali Tepelena pn., 70000, Ferizaj	18.07.2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja te QKMF-së	PO	734.24	866.40	JO

Korrigjimi i vlerës totale të ofertës me TVSh është bërë gabim që bie ndesh me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP)

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës me TVSH e korrigjuar
1.	OE.Alfa Dent SHPK	792.98 €
2	OE. Promedical SHPK	840.24 €
3.	OE. VitaMed LLC	1,388.41 €

Kalkulimet, në përputhje me LPP, janë paraqitur në Tablen A, ndërsa korrigjimi i gabuar nga AK për TVSh është bërë sipas Tablen B. Më poshtë janë paraqitur kalkulimet e bëra nga AK dhe siç duhet të bëhen, ky kalkulim është bërë nga OE Pro Medical si krahasim dhe korrigjime.

Tabela A		Korrigjimi i sakte i TVSh duhet të bëhet në këtë menyrë				
Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Çmimi me TVSh sipas procesverbalit	Norma TVSH 8% ose 18%	Korrigjimi i TVSH duhet bere nga AK për arritur tek çmimi me TVSH 5 (3/1.08 =5)	Çmimi me TVSh nuk duhet të ndryshoj në përjashtim gabimet aritmetike ±2%.	Shenim
1	2	3	4	5	6	7
1	OE. VitaMed LLC	1,517.00 €	8%	1,404.63 €	1,517.00 €	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim
2	OE. Promedical SHPK	846.50 €	8%	782.20 €	846.50 €	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim
3	OE.Alfa Dent SHPK	866.40 €	8%	802.22 €	866.40 €	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim

Koment dhe Sqarim për Tabellën A: Korrighjimi aplikohet vetëm për çmimin pa TVSh, ndërsa çmimi me TVSh mbetet i pandryshueshëm në përashtim kur ka gabime aritmetike ($\pm 2\%$), sipas nenit 59.3 të LPP. Ky çmim, si ai për njësi, ashtu edhe ai i shfaqur në formularin e dorëzimit të ofertave, konsiderohet si i fiksuar dhe i pandryshueshëm, nese nuk ka gabim aritmetike.

Çdo ndryshim i çmimit me TVSh në formularin e çmimit të dorëzuar dhe çdo korrighjim/modifikim i tij do të trajtohet si gabim aritmetik, sipas nenit 59.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe nenit 40.9 të Rregullores për Prokurimin Publik. Gabimet e tilla mund të korrighjohen brenda një tolerance prej $\pm 2\%$ si gabime aritmetike të pranushme bie ($\pm 2\%$), nuk pranohet dhe eliminohet OE.

Për korrighjimin, çmimi me TVSh do të ndahet / largohet me normën përkatëse të TVSh-së, në këtë rast 8%, për të përcaktuar çmimin pa TVSh, pra Çmimi me TVSh- norma e TVSh pra vlera e TVSh= Çmimi pa TVSh.

Çmimi me TVSh / 1.08 = Çmimi pa TVSh. Ky korrighjim nuk kërkon komunikim me OE-në, pasi nuk ka ndikim në çmimin e furnizimit ose vlerën e kontratës. Qëllimi i këtij korrighjimi është saktësimi i TVSh-së për nevoja të institucioneve të tjera, si p.sh. ATK.

Tabele B						
Korrighjimet sipas AK						
Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Çmimi pa TVSH	Norma TVSH 8% ose 18%	Vlera e TVSh AK ka kalkular me 8% të gjitha pozicionet 5 X 8%=7	Çmimi me TVSh sipas AK pas korrighjimit 5+7=8	Shenim
1	2	3	4	5 (3 X 8% =5)	6 (3+5=6)	7
1	OE. VitaMed LLC	1,258.57 €	8%	100.69 €	1,359.26 €	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim
2	OE. Promedical SHPK	778.00 €	8%	62.24 €	840.24 €	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim
3	OE. Alfa Dent SHPK	734.25 €	8%	58.74 €	792.99 €	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim

Komentin dhe sqarimit për Tabelën B :

Në kalkulimin e bërë nga AK në Tabelën B, është evidentuar një gabim metodologjik, pasi çmimi pa TVSh është marrë nga procesverbali dhe më pas është shumëzuar me normën e TVSh-së prej 8% për të llogaritur çmimin me TVSh, pra Çmim pa TVSH + TVSH = Çmimi total me TVSH' është i pasaktë, pasi ndryshon të gjitha ofertat financiare dhe krijon mospërputhje thelbësore me formularin e çmimeve dhe paramasës dhe kjo metodë ka sjellë ndryshime në çmimet për njësi dhe, si pasojë, në vlerën totale të kontratës.

Kjo mënyrë e llogaritjes është e gabuar dhe ka çuar në ndryshime të çmimit me TVSh mes paramasës, procesverbalit dhe formularit të ofertës. Ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), dhe në këtë rast konkret, duhet të trajtohet si gabim aritmetik sipas nenit 59.3 të LPP-së dhe nenit 40.9 të Rregullores për prokurimin publik, si një gabim që duhet të jetë brenda kufirit të tolerancës prej $\pm 2\%$.

Përmbledhje, analizë krahasuese dhe identifikim i diferencave										
Tabela A				Tabela B				Tabela C		
Çmimet sipas procesverbalit / Formularit e çmimeve				Korrigjimet sipas AK				Shenimet dhe sqarimet sipas OE ankueses		
Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Çmimi pa TVSh	Çmimi me TVSh sipas procesverbalit	Çmimi pa TVSh	Norma TVSh 8% ose 18%	Vlera e TVSh AK ka kalkular me 8% të gjitha pozicionet 5 X 8%=7	Çmimi me TVSh sipas AK pas korrigjimit 5+7=8	Diferenca ndërmjet çmimit me TVSh në procesverbal dhe çmimit me TVSh pas korrigjimit nga AK % 8-4=9	Diferenca ndërmjet çmimit me TVSh në procesverbal dhe çmimit me TVSh pas korrigjimit nga AK 9/4=10	Shenim
1	2	3	4	5	6	7 (5x8=7)	8 (5+7=8)	9	10	11
1	OE. VitaMed LLC	1,285.57 €	1,517.00 €	1,285.57 €	8%	102.85 €	1,388.42 €	128.58 €	8.48%	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim.
2	OE. Promedical SHPK	778.00 €	846.50 €	778.00 €	8%	62.24 €	840.24 €	6.26 €	0.74%	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim.
3	OE. Alfa Dent SHPK	734.25 €	866.40 €	734.25 €	8%	58.74 €	792.99 €	73.41 €	8.47%	Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me normën e reduktuar prej 8%, pa e konsideruar si gabim.

Koment dhe Sqarim i Tabelës C, si dhe Krahësim Ndërmjet Tabelës A, Tabelës B dhe Tabelës C
Në këtë analizë, ne po shqyrtojmë ndryshimet ndërmjet çmimeve të paraqitura në Tabelën A, të korrigjuara nga Autoriteti Kontraktues (AK) në Tabelën B, dhe ndryshimet përkatëse të evidentuara në Tabelën C, që përfshijnë shpjegime dhe diferencat për OE. Të tre tabelat ndihmojnë në vlerësimin e saktësisë së çmimeve të ofruara dhe përputhshmërisë me rregulloret e prokurimit publik.

Përmbajtja e tabelave:

Tabela A: Përmban çmimet origjinale / fillestar sipas procesverbalit dhe formularëve të çmimeve të dorëzuara nga operatorët ekonomikë (OE). Çmimet përfshijnë me TVSh-në dhe janë të dokumentuara sipas ofertave të ofruara fillimisht.

Tabela B: Reflekton korrigjimet e bëra nga AK, ku çmimi është rregulluar nga çmimi pa TVSh dhe është aplikuar një normë e vetme TVSh prej 8%. Ky korrigjim ka shkaktuar ndryshime në vlerën përfundimtare të ofertave total me TVSh.

Tabela C: Shpjegon dhe ndriçon diferenca për OE, duke krahasuar çmimet e korrigjuara me çmimet fillestare dhe duke dhënë arsytet për ndryshimet. Ajo gjithashtu vlerëson nëse ndryshimet janë të pranueshme ose jo, duke mbështetur vlerësimin në rregulloret përkatëse.

- Analizë për OE: VitaMed LLC

- Çmimi me TVSh sipas procesverbalit: 1,517.00 €
- Çmimi me pa TVSh sipas procesverbalit: 1,285.5 €
- Norma e TVSh: 8% (e saktë 8% kanë aplikuar 18% gabim)
- TVSh e kalkuluar nga AK: 100.68 €
- Çmimi me TVSh pas korrigjimit nga AK: 1,388.41 €
- Diferenca me çmimin fillestar me TVSh dhe në %: 128.58 € ose **8.48%**
- Në Tabelat tek shënimet theksohet se: Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me 8%.

Kjo sjell mospërputhje midis çmimit fillestar të ofertuar dhe atij të korrigjuar nga AK, e cila ka një devijim prej 8.48% të papranueshëm, pasi ndryshon vlerën e ofertës përfundimtare. Ky veprim bie ndesh me nenin 59.3 të LPP-së dhe nenin 40.9 të Rregullores për prokurimin publik, si gabimet aritmetike mund të pranohet pas korrigjimit vetëm brenda një margjine ±2%.

Në këtë rast, diferenca prej 128.58€ përbën afërsisht 8.48%, çka e tejkalon dukshëm pragun e lejuar dhe duhet të trajtohet si gabim aritmetik i cili është mbi **2%**.

- Analizë për OE: Promedical SHPK

- Çmimi me TVSh sipas procesverbalit: 846.50 €
- Çmimi me pa TVSh sipas procesverbalit: 778.00 €
- Norma e TVSh: 8%
- TVSh e kalkuluar nga AK: 62.24 €
- Çmimi me TVSh pas korrigjimit (AK): 840.24 €
- Diferenca me çmimin fillestar me TVSh dhe në %: 6.26 € ose **0.74%** edhe pse pozicion 3 ka pasur normën 18%.

- Në Tabelat tek shënimet theksohet se: Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion 3 ishte 18% por AK ka aplikuar të gjitha me 8%, është pranuar kalkulimi me 8% nga AK.

Sqarim: Ky ndryshim, i cili është brenda kufirit të lejuar prej $\pm 2\%$, pra 6.26 € ose 0.74% mund të konsiderohet si një gabim aritmetik i pranueshëm. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht faktit se norma e TVSh ishte 18% për një pozicion pra pozicion 3, AK ka aplikuar një normë të vetme 8% për të gjitha pozicionet, diferenca prej 6.26 € bie brenda kufirit $\pm 2\%$, prandaj mund të konsiderohet si gabim aritmetik i lejuar.

- Analize për OE: Alfa Dent SHPK

- Çmimi me TVSh sipas procesverbalit: 866.50 €
- Çmimi me pa TVSh sipas procesverbalit: 734.25 €
- Norma e TVSh: 8% e sakt 8% kanë aplikuar 18% gabim
- TVSh e kalkuluar nga AK: 58.74 €
- Çmimi me TVSh pas korrigjimit (AK): 792.98 €
- Diferenca me çmimin fillestar me TVSh dhe në %: 73.41 € ose **8.47%**
- Në Tabelat tek shënimet theksohet se: Pavarësisht se norma e TVSh-së për një pozicion ishte 18%, është pranuar kalkulimi me 8%.

Vlerësim: Diferenca është shumë më e lartë se 2%, pra është **8.47%** dhe nuk mund të konsiderohet si gabim aritmetik i pranueshëm. Ndryshimi i normës së TVSh-së dhe kalkulimi nga Autoriteti Kontraktues i çmimit pa TVSh ka sjellë një ndryshim të konsiderueshëm, i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në renditjen e operatorëve ekonomikë. Kjo ndodh sepse çmimi total me TVSh përbën bazë për vlerësimin e ofertave, dhe çdo devijim në përllogaritje cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Si i tillë, veprimi i ndërmarrë është në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse që rregullojnë procedurat e prokurimit publik.

Komente të përbashkëta për të tre OE-të:

- Në të gjitha rastet, AK ka aplikuar një normë unifikuar të TVSh-së (8%) pavarësisht një pozicion 3 ka pasur TVSh 18%.
- Korrigjim i njëanshëm nga AK për çmimin për njësi dhe çmimit total konsiderohet ndryshim thelbësor i ofertës, që bie në kundërshtim me nenin 59.3 të LPP-së dhe nenin 40.9 të Rregullores për prokurimin publik.
- Vetëm OE Pro Medical SHPK, ndryshimi është brenda kufirit $\pm 2\%$

Duke u bazuar në këtë interpretim të KRPP, veprimi i duhur do të ishte që çmimi me TVSh duke zbritur normën përkatëse të TVSh-së (8% ose 18%), në mënyrë që të arrihej çmimi **pa TVSh**, pa ndikuar në çmimin total me TVSh dhe në çmimin për njësi përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, duke mos ndjekur këtë praktikë të drejtë, ka realizuar ndryshime tërësore në çmimet për njësi dhe në vlerën totale për 32 pozicione për OE ofertues në përjashtim të Pro Medical.

Këto ndryshime përfshijnë modifikimin e çmimit për njësi dhe përllogaritjen e shumës totale (Sasia \times Çmimi për njësi = Shuma), duke çuar në devijime të konsiderueshme dhe jo proporcionale, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Korrigjimi i saktë duhet të bëhet në këtë mënyrë, si më poshtë:

Procurement Internal No Broj nabavke:		037-25-1030-1-3-6		Contract Title Naslov ugovoru		Sticky Note Administrator 4/22/2025 4:39:15 PM Options Korrigjimet behet ne kete menyre pra Çmimi me TVSh / 1.08 = Çmimi pa TVSh	
Numri i brendshëm Internal No		KKHE-25-009-1-3-6					
Interni broj							
Data e lëshimit Date of issue		Data e mbylljes Closing date		Data e hapjes & Ora Opening date & time		Vendi Place	
Datum izdavanja		Datum zatvaranja & Čas		Datum Otvaranja & Čas		Mesto	
18.03.2025		18.03.2025, 14:00:00		18.03.2025, 14:00:00		Permes platformës së prokurimit elektronik	
						Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders	
						Br. Primljenih Tendera	
						3	

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	VitaMed L.L.C., Rr. Ramadan Peci, 40000, Mitrovica	17.03.2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja të QKMF-së	PO	1285.57 1,404.63	1517.00	JO
2.	PRO MEDICAL SH.P.K., Rr. Kadri Zeka, 70000, Ferizaj	02/2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja të QKMF-së	PO	778.00 782.20	846.50	JO
3.	Alfa Dent SH.P.K., Rr. Ali Tepelena pn., 70000, Ferizaj	18.07.2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja të QKMF-së	PO	734.24 802.22	866.40	JO

Korrigjimi i gabuar nga AK ka bërë në këtë mënyrë, si më poshtë:

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	659-25-1656-1-3-6	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Furnizim me mater
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	KKHE-25-009-1-3-6		
Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto
18.03.2025	18.03.2025, 14:00:00	18.03.2025, 14:00:00	Permes platformes se prokurimit elektronik 3

Nr. Br.	Tenderesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotesimi Supplement/Amendment Dopuna/Izmjena
1.	VitaMed L.L.C., Rr. Ramadan Peci, 40000, Mitrovice	17.03.2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja te QKMF-së	PO	1285.57	1517.00 1,388.41	
2.	PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj	02/2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja te QKMF-së	PO	778.00	846.50 840.24	
3.	Alfa Dent SH.P.K., Rr.Ali Tepelena pn., 70000, Ferizaj	18.07.2025	Furnizim me material stomatologjik për nevoja te QKMF-së	PO	734.24	866.40 792.98	

Pra ndryshimi i çmimin me TVSh, pasi ai buron nga çmimi për njësi i shumëzuar me sasinë = Totali (ose shuma). Interpretimi i dhënë nga KRPP është i qartë dhe, për këtë arsye, nuk ka pasur nevojë për sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Në kundërshtim me këtë interpretim sipas AK i publikuar ne e-prokurimim dhe ne Vendimin e AK, por AK është bazuar gabishm në LS dhe Vendimin për Refuzim të kërkesës tone, ne si OE kemi sqaruar AK lidhur me TVSh edhe AK nuk ka marr asnjë informacion shtes nga OE tjerë edhe pse nuk kemi pasur detyrim ligjor për por kemi informuar AK. Megjithatë, kemi ofruar të gjitha sqarimet e nevojshme, vetëm për të ndihmuar në qartësimin e situatës, duke pasur parasysh që dy Operatorë Ekonomikë nuk kanë ofruar të dhëna të mjaftueshme në lidhje me normën e TVSh-së që aplikohet (shiko emial), kurse AK përkundrazi, ka favorizuar operatorin e dytë dhe ka rekomanduar nënshkrimin e kontratës, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Në paramasë e AK kanë qenë e paraqitur, kanë qenë të përfshira këto kolona me përshkrimet përkatëse: **Nr.; Përshkrimi i furnizimit; Njësia; Çmimi për njësi; dhe Shuma.**

Siç mund të vërehet, nuk ka pasur kolona për 'Çmimi pa TVSh', 'Norma e TVSh-së', dhe 'Totali pa TVSh'.

Vetëm kolona për 'Çmimi për njësi' dhe 'Shuma' (ose 'Totali') ishin të përfshira në

Për sqarim dhe informacion, Çmimi për njësi përfshin të gjitha detyrimet dhe taksat, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, sipas dispozitës DT 5.1.

FURNIZIM ME MATERIAL STOMATOLOGJIK					
Nr.	PËRSHKRIMI I FURNIZIMIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi	Shuma

Pretendimi 2

Autoriteti kontraktues, në përpjekje për të favorizuar OE Alfa Dent dhe për të ndryshuar renditjen e operatorëve ekonomikë, ka bërë një gabim të qartë në lidhje me vlerën e ofertës së këtij OE.

Konkretisht, është vërejtur një ndryshim i çmimit për OE e rekomanduar nga **866.40 euro** në **792.98 euro**, që përbën një devijim të konsiderueshëm nga çmimi origjinal / fillestar sipas procesverbalit të hapjes dhe në Formularin e Dorëzimit të Ofertës.

Ky ndryshim tejkalon përqindjen prej 2% të gabimit të lejuar, dhe duhet të konsiderohej si korrigjim aritmetik nga AK sipas nenit 59.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) ose nenit **40.9, pika b, të Rregullores për Prokurim Publik.**

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka gabuar në dy aspekte: së pari, në mënyrën se si ka trajtuar këtë mospërputhje, dhe së dyti, në moszbatimin e saktë të dispozitave të LPP-së, përkatësisht nenit 59, duke e trajtuar situatën në një mënyrë që cenon parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në përpjekje për të favorizuar OE-në e rekomanduar për kontratë, AK ka bërë një shkelje flagrante të nenit 40.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, duke korrigjuar çmimin total me TVSh në mënyrë të papranueshme dhe të paarsyeshme.

a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Autoriteti kontraktues ka pranuar, edhe pse ka ndodhur një devijim mbi 2% pra nga 866.40 në shumën totale prej 792.98 € për OE Alfa Dent, siç është e reflektuar në Letrat Standarte dhe Vendimin e AK.

Sidoqoftë, në përputhje me nenin 40.9, pika b, të **RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**, duhet të ishte eliminuar oferta e Alfa Dent dhe e VitaMed, pasi ndryshimi i çmimit përtej kufirit të lejuar prej $\pm 2\%$ është një shkelje e RREGULLORES PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Sipas këtij neni:

b. Në rast se shuma e korrigjuar është me shume se $\pm 2\%$, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.

Ndryshimi çmimit për OE Alfa Dent prej 866.40 euro dhe 792.98 euro është rreth **8.47%**, që është dukshëm më i lartë se përqindja e lejuar prej 2% , pra **pika 10 UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK 10, deri sa ka ndryshim në mes Formularit të tenderit dhe LS dhe Vendimit të AK pas korrigjimeve aplikohet ky sqarim me poshtë sepse mos plotësimi i saktë i Formularit të tenderit / çmimit është kusht Administrativ dhe Tenderi Refuzohet pa kërkuar infoacione shtesë**

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
--	---	---------------------

Ky sqarim jepet për shkak të një mospërputhjeje që tejkalon përqindjen e lejuar prej $\pm 2\%$, pasi devijimi arrin në 8.48% për VitMed dhe **8.47% për Alfa Dent** kurse për OE Pro Medical 0.74% ndërmjet të dhënave të paraqitura në Formularin e Tenderit/Procesverbalin e hapjes dhe korrigjimeve të bëra nga Autoriteti Kontraktues.

Ishte çmimi në Formularin e Tenderit për Alfa Dent:

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Furnizim me material stomatologjik për nevoja të QKMF-së

3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i OE rekomanduar

866.40 EUR

Dhe në fjale (shëno çmimin e tenderit në fjale Euro)

Është bërë ndryshimi për Alfa Dent:

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës me TVSH e korrigjuar
1.	OE.Alfa Dent SHPK	792.98 €
2	OE. Promedical SHPK	840.24 €
3.	OE. VitaMed LLC	1,388.41 €

Gjithashtu, një tjetër mospërputhje është vërejtur ndërmjet Formularit të Tenderit për Alfa Dent dhe Dokumentit të Tenderit (DT). Sipas DT-së, kuotimi i çmimeve duhet të jetë i **vlefshëm për 60 ditë** nga afati i dorëzimit të ofertave, ndërsa operatori ekonomik (OE) ka deklaruar **vlefshmëri prej 90 ditësh**. Kjo bie ndesh me pikën 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, të cilën e kemi përmendur më lart.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në mënyrë të njëanshme, duke synuar favorizimin e këtij OE-je në çdo rrethanë, pa marrë parasysh nëse është plotësuar ose jo Formulari i Çmimeve sipas kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), edhe pse kjo është në kundërshtim të qartë me nenin 10 përkatës të Udhëzuesit Nr. 002/2024.

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose ditë: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

IV.5 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Kuotimi i çmimeve do të jetë i vlefshëm për **60** ditë nga afati i dorëzimit të kuotimeve të çmimit.

Këto gabime kanë qenë të pranishme që në fillim të procesit, siç është theksuar edhe në pretendimin tonë të mëparshëm, por Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë në konsideratë dispozitat e Nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Kurse AK me ndryshimet e bere kai shkelur **Neni 59.4 pikën (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë**, sepse AK ka ndryshuar paramasen e OE te rekomanduar të gjitha çmimet për njesi dhe keni ndryshuar kushtin e material dhe ndryshim për të gjitha pozicionet është mbi 8%.

Ju lutem shikoni paramasë dhe dokumentet tjera për OE e rekmomandu si dëshim të bashkangjitur kësaj Ankese.

Të gjitha këto janë përmendur edhe në Pretendimin 1, përmes tabelave dhe krahasimeve në Tabelat A, B dhe C. Gjithashtu, kësaj Kërkese për Rishqyrtim i kemi bashkëngjitur të gjitha tabelat dhe kalkulimet përkatëse si provë materiale.

Ritheksim:

Një ndryshim i tillë, siç ka vepruar AK, mund të ketë pasoja serioze në procesin e prokurimit publik, pasi përbën një rast tipik të shkeljes së Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ky veprim ndryshon në mënyrë thelbësore përmbajtjen e ofertës së operatorëve ekonomikë, veçanërisht në aktivitetet e prokurimit ku zbatohen norma të ndryshme të TVSH-së. Prandaj, veprimi i AK-së, qoftë me vetëdije apo pa vetëdije, rrezikon të shkaktojë pasoja të rënda në funksionimin e sistemit të prokurimit dhe të çojë në keqpërdorim të parasë publike.

Kjo ankesë është paraqitur kryesisht si një veprim parandalues dhe vetëdijesues për AK-në. Megjithatë, nëse një situatë e tillë vazhdon, do të detyrohemi të informojmë organe të tjera përkatëse, me qëllim që të realizohet një vlerësim dhe hetim i detajuar lidhur me këto ndërhyrje në paramasat dhe ofertat e operatorëve ekonomikë.

Ne kërkojmë që ekspertit shqyrtues të realizojë një vlerësim profesional dhe financiar lidhur me pretendimet tona, pasi korrigjimet e bëra nga AK në paramasat dhe çmimet totale me TVSH kanë sjellë ndryshime të mëdha. Këto korrigjime janë bërë duke llogaritur çmimet nga vlera pa TVSH, çka ka ndikuar në mënyrë drastike në renditjen e operatorëve ekonomikë. Një veprim i tillë mund të nxisë operatorët që të deklarojnë çmime me TVSH jo të sakta, me arsyetimin se ato do të korrigjohen më pas nga autoriteti kontraktues.

Duam të theksojmë se në dosjen e tenderit është specifikuar qartë se operatorët ekonomikë duhet të përfshijnë në ofertën financiare të gjitha tatimet dhe taksat e aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Prandaj, ndërhyrjet në ofertat financiare nga ana e AK-së janë të papranueshme

VENDIM

- Të anulohet B58-Njoftim mbi Vendimin e autoritetit kontraktues, dt. 18.04.2025
- Të konsiderohet SI TË BAZUAR të gjitha pretendimet në ankesën tonë dhe të kthejë në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Diskriminimi në pjesëmarrjen në këtë aktivitet të prokurimit duke shkaktuar dëme materiale dhe financiare

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- A. Table dhe karahasim dhe provat tjera
- B. Pramasat e OE të rekomanduara
- C. Kalkulimet e AK dhe korrigjimet
- D. Proces verbale hapjes